



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

Lindita NIKOLLA

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË PËR VITIN 2023**

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke vlerësuar si një arritje të rëndësishme bërjen operationale dhe fillimin nga puna të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, në datë 12.4.2023, si dhe rritjen graduale të numrit të anëtarëve të regjistruar të bursës;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm miratimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili përmirëson kuadrin rregullator bazë ligjor të energjisë së rinovueshme në Shqipëri, përafro legjislacionin shqiptar me *acquis* e BE-së, duke synuar ndër të tjera edhe rritjen e diversifikimit të burimeve të energjisë dhe sigurinë e furnizimit me energji në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar trendin pozitiv të uljes së nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, i cili vijon të ketë një rënie nga viti në vit, humbjet e energjisë elektrike për vitin 2023 arritën në nivelin 18.93%, duke shënuar një ulje të mëtejshme krahasuar me vitin 2022 (19.7%), ndërkohë niveli total i arkëtimeve për vitin 2023 arriti shifrat 99.4% duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2022 (98%);

Vlerëson për vitin 2023:

- Punën e ERE-s në publikimet e vazhdueshme në rrjetet sociale për veprimtarinë e institucionit, si dhe informacione të nevojshme për konsumatorët për të drejtat e tyre apo mesazhe sensibilizuese për kursimin e energjisë elektrike, broshura informative për konsumatorin, si dhe informacione të tjera që i shërbejnë konsumatorit.

- Punën e bërë nga ERE-ja lidhur me implementimin e Platformës së Krahasimit të Çmimeve (PCT), si një hap i rëndësishëm drejt promovimit të një tregu konkurrues e alternativ të çmimeve të furnizimit me energji elektrike për të gjithë ata konsumatorë të cilët kanë plotësuar kriteret ligjore të daljes në treg të lirë.

- Punën e bërë nga ERE-ja duke miratuar gjatë vitit 2023 vendime të rëndësishme për krijimin e një tregu funksional gazi, i cili shfrytëzon potencialin e infrastrukturës ekzistuese në vend dhe që krijon bazat për planet e zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës.

- Punën dhe bashkëpunimin nga ana e ERE-s për të bërë të mundur që nga data 1 janar 2024 të gjithë klientët e lidhur në 20 kV të furnizohen në treg të liberalizuar.

- Punën e bërë nga ERE-ja për nënshkrimin e *Memorandum of Understanding* (MOU) me përfaqësues të Entit Rregullator të Italisë, Maqedonisë së Veriut, Greqisë për bashkimin e tregjeve të ditës në avancë brenda vitit 2026.

- Punën e bërë nga ERE-ja në kuadër të forcimit të standardeve të sigurisë kibernetike për vetë rregullatorin, duke përmbyllur me sukses procedurën me objekt "Përmirësimi i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit të ERE-s dhe implementimi i firewall".

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2024 i rekomandon ERE-s:

1. Të japë kontributin e saj dhe të luajë një rol proaktiv për të bërë të mundur rritjen e volumit të tregtuar në bursë dhe pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në fushën e energjisë, si dhe të vijojë punën për realizimin e bashkimit të tregjeve të energjisë së një dite më parë si një sfidë e rëndësishme, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e efikasitetit të impianteve të prodhimit të energjisë së rinovueshme të Shqipërisë në tregun rajonal dhe më gjerë.

2. Në kuadër të rritjes së sigurisë kibernetike, nga njëra anë, të monitorojë nivelin e implementimit të Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në sektorin e energjisë elektrike nga operatorët, si dhe shtrirjen e saj edhe në sektorin e gazit natyror dhe, nga ana tjetër, të bashkëpunojë me AKCESK për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe përfshirjen e infrastrukturave kritike të energjisë.

3. Gjatë miratimit të planit të investimeve të shoqërive t'u kushtojë vëmendje të veçantë investimeve në zonat turistike të vendit, zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, për më tepër, duke pasur parasysh ritmet me të cilat po rritet numri i turistëve në vend, duhet të shoqërohet edhe me investime në fushën e energjisë.

4. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të tij, kërkesë edhe në progresraportin e KE-së, të shfrytëzojë Shkollën Ballkanike të Energjisë, e cila tashmë është funksionale, për shkëmbimin e eksperiencave midis rregullatorëve lidhur me problematikat që lidhen me bashkimin e tregjeve apo dhe problematika e sfida të tjera në fushën e energjisë.

5. Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe duke iu referuar praktikave më të mira të vendeve fqinje, si: Italia dhe Greqia, të punojë për krijimin e lehtësirave të mëtejshme në instalimin e paneleve fotovoltaike nga përdoruesit e energjisë elektrike.

6. Të vijojë të ketë në fokus të punës së tij dhe të rrisë përpjekjet në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit në rastet kur këto të fundit përballen me mbifaturim, keqfaturim/faturim aforfe, dëm ekonomik e tarifim i gabuar nga ana e operatorit të shpërndarjes apo edhe ngarkimit pa të drejtë me përgjegjësi të konsumatorëve kur konstatohen ndërhyrje apo dëmtime të matësve të vendosur në ambiente të përbashkëta.

7. Të japë kontributin e nevojshëm për ndryshimet ligjore në ligjin e energjisë për transpozimin e paketës së re të legjislacionit evropian në sektorin e energjisë elektrike.

8. Si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës, të vijojë të japë kontributin e saj për hartimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2020-2030, siç kërkohet edhe nga progresraporti i KE-së.

9. Të vijojë punën për miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për vendosjen e detyrimit të përdorimit të Platformës së Krahasimit të Çmimeve (PCT) në tregun e lirë, si dhe të zhvillojë fushata promovuese mbi modalitetet e funksionimit të saj.

10. Pas vlerësimit që do të bëjë Grupi i Punës, të marrë masat e nevojshme për adresimin e pengesave të mundshme të diversifikimit të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë të miratojë aktet rregullatore që dalin si detyrim i ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, për të nxitur më tej shfrytëzimin e burimeve diellore dhe të erës në funksion të diversifikimit të burimeve të energjisë, duke e bërë sistemin më pak të ekspozuar ndaj ndikimeve klimatike.

11. Të punojë për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë, marrëveshje e cila, në kuadër të adresimit të sfidave të përbashkëta, të ketë në fokus të saj hartimin e një strategjie të përbashkët afatmesme për adresimin e çështjeve me interes të konsumatorit sa i përket përdorimit eficient të energjisë.

12. Të vijojë bashkëpunimin me rregullatorët e Italisë dhe Greqisë për mundësitë e rritjes së kapacitetit transmetues të TAP Ag në nivel rajonal.

Miratuar në datën 27.6.2024